

VENDIM
Nr. 648, datë 22.11.2023

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 420, DATË 8.6.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT SHTETËROR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në kapitullin V, pika 2, “Përdorimi i sallës VIP të aeroportit”, në fund të nënpikës 2.3, shtohen këto autoritete:

“... - Zëvendëskryetari dhe gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

- Zëvendësdrejtuesi dhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

- Krerët e misionëve diplomatike të Republikës së Shqipërisë.”.

2. Në kapitullin VI, pika 1, “Përparësia në Republikën e Shqipërisë”, në rangun II të përparësive, bëhen këto shtesa:

a) Pas emërimit “... Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme...” shtohet “... Zëvendësdrejtuesi i Prokurorisë së Posaçme; ...”;

b) Pas emërimit “... Kryetari i Gjykatës së Posaçme ...” shtohet “... Zëvendëskryetari i Gjykatës së Posaçme; ...”.

II. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku